



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:012271

Datë: 26.10.2018

Numri i dokumentit: 00155682

P. nr.287/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-Departamenti I përgjithshëm- me Gjyqtaren Diana Sina, me sekretaren juridike Lamije Kuqi, duke vendosur në lëndën penale kundër të akuzuarit B.V.Q.nga Gjakova rruga “A.T.” nr. 132, sipas Aktakuzës të PTH-DP në Gjakovë, PP.nr. 356/2018 të datës 03.04.2018, për shkak të veprës penale, te kanosjes nga neni 185 prg 1 të KPRK-ës, duke vendosur në lidhje me propozimin për dhënien e urdhër ndëshkimor me datën **19.09.2018**, mua këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e PTH-DP në Gjakovë, PP.nr. 356/2018 të datës 03.04.2018 dhe kjo Gjykatë, jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I A K U Z U A R I:

B.Q.nga i ati V.dhe e ëma H. e gjinisë I., data e lindjes... në Gjakovë, ku edhe tani banon në rrugën “A.P.T.” nr.132, me nr. personal, ka te kryer tri klase te shkollës fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar-shtetas i Republikës së Kosovës, me parë i pa dënuar.

Ë s h t ë f a j t o r :

Me datën 28.12.2017 rreth orës 09:30 min, ne shkollën fillore “M.B.” në Gjakovë, me qëllim te frikësimit ose shkaktimit të ankthit ka hyrë në korridorin e shkollës dhe gjersa po ngjitej shkalleve lartë ka bërëtitur dhe ka përdorur fjalë kërcënuese ndaj të dëmtuarës Z. K. tek zyra e saj e si drejtoreshë e kësaj shkolle, e që nxënësit B. Q.- djali i te akuzuarit vijon mësimet aty, dhe kjo me arsyetimin se pse djali i tij ishte sanksionuar me një masë disiplinore në shkollë për shkak se i njëjti kishte pasur probleme me një nxënës , në atë mënyrë i akuzuari përdor fjalët “ ta di shpinë dhe do te vijë ta vras burrin” ashtu që ka vazhduar me fjalët tjera dhe bashkë me djalin e tij doli nga shkollla, me çka te dëmtuarës i ka shkaktuar ne mënyrë serioze shqetësim dhe ankth te përcjellur edhe me frikë.

- me çka ka kryer veprën penale, të kanosjes nga neni 185 prg 1 të KPRK-ës

Andaj, Gjykata komfor nenit 4,41,43,46,73 dhe nenit 185 par.1 të KPRK-ës, dhe nenit 495 të KPPK-ës, të akuzuarit,

I SHQIPTON

Dënim me gjobë në shumën prej **300.-(Treqind).-€**, të cilën dënim duhet ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së Aktgjykimit.

Nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën, Gjykata në bazë të nenit 46 par.3 të KPRK-ës, dënimi me gjobë do ta zëvendësoi me dënim burgu në kohëzgjatje prej **15(Pesëmbëdhjetë) ditësh**, duke llogaritur çdo ditë të qëndrimit në burgim nga **20.-(njëzet) euro, të gjobës**.

Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve procedurale, në emër paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **20,00.-Euro**, e krejt këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

E dëmtuara Z.K. nga Gjakova, Rr.”H. . D. “, kompensimin e dëmit mund ta realizonë në kontest civil.

A r s y e t i m

Pranë kësaj Gjykate Prokuroria Themelore-Departamenti i përgjithshëm në Gjakovë, ka ngritur Aktakuzë PP.nr.356/2018 të datës 03.04.2018, kundër të akuzuarit B. Q. nga Gj., për shkak të veprës penale, të kanosjes nga neni 185 prg .1 të KPRK-ës, me propozim që ndaj të akuzuarit ti epet urdhër ndëshkimor dhe të njëjtit ti shqiptohet dënimi me gjobë pa mbajtur shqyrtimin gjyqësor.

Gjykata me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes komfor nenit 495 të KPPK-ës gjeti se janë plotësuar kushtet nga dispozita e nenit 493 të KPPK-ës dhe pa mbajtur shqyrtimin gjyqësor, vendosi që të pranoi kërkesën e PTH-DP në Gjakovë, për dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe ti shqiptoi ndaj të akuzuarit dënim me gjobë si në dispozitiv të Aktgjykimit.

Para se të vazhdohet me arsyetim të Aktgjykimit për palën e pa udhëzuar është e nevojshme që ti referohet dispozitës së nenit 185 par.1 të KPRK-së e cila dispozitë për kryesin e kësaj vepre penale parasheh dënim me gjobë ose me burgim gjerë në gjashtë muaj.

Gjykata vlerëson se provat që janë bashkangjitur propozimit për dhënien e urdhrin ndëshkimor të cilat gjinden në shkresat e lëndës siç janë:

- Raporti fillestar i incidentit me nr. rastit 2017- EA- 1428, te dt. 28.12.2017,
- Deklarata e të dëmtuarës Z.K. dhënë në Stacionin policor në Gjakovë, me dt. 28.12.2017 .
- Deklarata e të akuzuarit B.Q. dhënë në Stacionin policor në Gjakovë, me dt.31.01.2018
- Raporti i oficerit të Stacionit Policor në Gjakovë,lidhur me rastin, Ri. M. # 10066 te dt. 28.12.2017.
- shkresat tjera ne lende.

Gjykata, këtë dënim e ka shqiptuar me bindje se me të njëjtin do te arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK-ës, në mënyrë që të parandaloi kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, si dhe të përmbajë personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale në emër të paushallit gjyqësor, është marr konform nenit 450 par. 1 dhe 2 nën paragraf 2.6 të KPPK-së.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 463 par.2 të KPPK-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi mbi urdhrin ndëshkimor.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
-Departamenti i përgjithshëm-
P. nr. 287/18 më datë 19.09.2018.

Sekretarja juridike,
Lamije Kuqi

Gj y q t a r j a,
Diana Sina

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi i akuzuari dhe mbrojtësi i tij mund të ushtrojnë Kundërshtim, në afat prej **8** ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës, Gjyqtarit të kësaj Gjykate. Nëse i pandehuri nuk ushtron kundërshtim, Aktgjykimi do të merre formë të prerë.